

SHARING STORIES.
SHAPING THE FUTURE:
DIALOGUES FOR SPACE

REPORT FOR WORKSHOP I

12-14 JUNE 2014

SHKËMBEJMË PËRVOJAT.
FORMËSOJMË TË ARDHMEN:
DIALOGJET PËR SPAÇIN

RAPORT I PUNËTORISË I

12-14 QERSHOR 2014



CONTENTS

PERMBAJTJE

Introduction	3	Hyrje
Workshop agenda	6	Axhenda e realizuar
List of participants	8	Lista e pjesëmarrëve
Working process	10	Procesi i punës
Impressions from the Spaç site visit	11	Mbresat nga vizita në Spaç
SWOT analysis	14	Analiza SWOT
Spaç in popular culture today	17	Spaçi në kulturën popullore sot
Life inside Spaç: testimonies from former political prisoners	18	Jeta brenda në Spaç: dëshmitë nga ish të burgosurit politikë
Mind maps of Spaç	23	Hartat mendore të Spaçit
Visits in Mirdita	27	Vizitat në Mirditë
Evaluation of the workshop	28	Vlerësimi i punëtorisë
Further information	36	Informacione të mëtejshme

INTRODUCTION

HYRJJE

Background

A number of the political prisoners who were taken to Spaç prison were artists, writers and other intellectuals, many of whom have spoken out about their experience in recent years. This has helped to make Spaç one of the most symbolic sites for the horror of persecution under the Communist regime, as well as perhaps the site that is most present in the collective memory of Albanians. As such, the primary value of Spaç today is as a much-needed place of memory for the crimes of the Communist regime—a physical space to 'locate' and address the traumas of that past, both for the former political prisoners who suffered there and for the rest of the Albanian people. Such sites of memory can represent not only the trauma of that period, but also resistance to and, ultimately, the downfall of the former regime.

Today, there seems to be a growing consensus among institutions, citizens and civil society actors that Spaç could and should serve as a place for documenting and confronting the abuses of human rights that occurred under the Communist regime. In addition, this site will be an important means of teaching Albanians and foreigners about this difficult period of history in a deep, experiential way. This comes at a time when tourism demand for former Communist sites is on the rise, potentially creating a much-needed economic opportunity for the local community, which is suffering from chronic poverty and steady emigration.

Finally, the success of Spaç in dealing with this specific type of heritage would make it possible to form a contemporary approach to revitalizing the sites of persecution in Albania, hoping that after Spaç, the same process could be undertaken for Qafë Bari, Bënça and so on with many more sites of conscience.

Prapavija

Spaç është një nga vendet emblematike të tmerrit të persekutimit Komunist dhe ndoshta vendi që më së shumti është i pranishëm në kujtesën kolektive të Shqiptarëve. Si i tillë, vlera parësore e tij sot është identifikimi nga të gjithë si vend shumë i nevojshëm i kujtesës së krimeve të regjimit Komunist – një vend fizik, ku jo vetëm ish të përndjekurit politikë por e tërë shoqëria, mishëron e shëron traumat e së kaluarës Komuniste. Të tillë vende të kujtesës mund të përfaqësojnë jo vetëm traumat e kësaj periudhe por gjithashtu rezistencën ndaj regjimit si dhe rënien e tij.

Duket të ekzistojë një lloj konsensusi i përgjithshëm mes institucioneve, qytetarëve dhe shoqërisë civile, që Spaç mund dhe duhet të jetë vendi i dokumentimit dhe i përballjes me abuzimet makabre ndaj të drejtave themelore të njeriut të kryera gjatë regjimit Komunist. Një vend i të tillë do të kishte dhe një dimension të rëndësishëm edukativ e arsimor që do të mundësonte për Shqiptarë e të huaj një përvojë të plotë dhe të prekshme për këtë periudhë të vështirë historike. Ky vizion përputhet gjithashtu me tendencat në rritje të turizmit në/për vendet e Komunizmit, çka do të gjeneronte mundësi jetike zhvillimi ekonomik për bashkësinë lokale që vuan prej kohësh nga varfëria dhe emigracioni.

Së fundmi Spaç si model i mirë i trajtimit të kësaj trashëgimie specifike do të formësonte një përjasje dhe një përvojë bashkohore të revitalizimit të vendeve të persekutimit, duke shpresuar që pas Spaçit t'u vijë rradha dhe Qafë-Barit, dhe Bënçës, e shumë vendeve të tjerë të ndërgjegjës.

The Dialogues for Spaç project

In 2014, Cultural Heritage without Borders (CHwB) began implementation of the project “Sharing Stories, Shaping the Future: Dialogues for Spaç”, with the support of the International Coalition of Sites of Conscience.

This project will organize a series of three workshops, with the following goals:

- Deepening our knowledge and understanding about Spaç as a monument and symbol of the heritage of the Communist regime and as the bearer of a memory that should not and cannot disappear;
- Proposing several functions for the site, with the purpose of turning it into a museum about the former Spaç prison,
- Joint discussion of a concrete action plan to give life to these proposals.

An essential part of this project is the creation of a common space for dialogue among individual and institutional voices. Each has its own history; its own experiences related to Spaç; its own point of view on the meaning and value of this site that symbolizes the repressive Communist system and, therefore, different expectations about its future.

The chart below outlines the main steps in the project:




Fig. 1: Project scheme

Projekti i Dialogjeve për Spaçin

Gjatë vitit 2014, CHwB ka filluar zbatimin e projektit “Shkëmbejmë Përvojat, Formësojmë të Ardhmen: Dialogjet për Spaçin”, me mbështetjen e International Coalition of Sites of Conscience.

Projekti synon organizimin e një serie prej 3 punëtorish me qëllim:

- Thellimin e njohurive për Spaçin si monument simbol i trashëgimisë së regjimit Komunist dhe si bartës i një kujtese që nuk duhet, nuk mund të zhduket,
- Propozimin e disa funksioneve me qëllim kthimin në muze të ish burgut të Spaçit,
- Diskutimin e përbashkët të një plan-veprimi konkret për ti dhënë jetë propozimeve.

Pjesë thelbësore e këtij projekti është krijimi i një hapësire të përbashkët për dialog mes zërave institucionalë dhe individualë që kanë historitë, përvojat e tyre në lidhje me Spaçin, pikëpamjet e tyre - jo domosdoshmërisht të njëjta - mbi kuptimin dhe vlerat e këtij vendi simbol të sistemit represiv Komunist, e për rrjedhojë, pritshmëri të ndryshme për të ardhmen e tij.

Skema e projektit në faqen tjetër përmbledh hapat kryesorë të projektit:

SHKËMBEJMË PËRVOJAT, FORMËSOJMË TË ARDHMEN: DIALOGJET PËR SPACIN

Skema e projektit




Fig. 2: Skema e projektit

Workshop I objectives

The goal of the first workshop was to open the dialogue process, laying the foundation for documenting Spaç as a site that is emblematic of political persecution in Albania, including here some personal testimonies from those who have experienced it directly.

On the other hand, this workshop also sought to equip all participants with a minimum knowledge about Spaç—its location, physical characteristics, as well as information taken directly from former political prisoners held there. The knowledge gathered in this way will be used in later steps of the project. Lastly, another goal of this workshop was to place Spaç within a wider network of touristic points found within the Mirdita region.

Objektivat e punëtorisë I

Punëtorja I kishte si synim hapjen e procesit të dialogjeve duke hedhur bazat për dokumentimin e Spaçit si hapësirë emblematike e persekutimit politik në Shqipëri, përfshirë këtu dhe disa prej dëshmivë njerëzore të atyre që e kanë përjetuar atë drejtpërsëdrejti.

Nga ana tjetër, kjo punëtori kërkonte gjithashtu të pajiste të gjithë pjesëmarrësit me një bagazh minimal njohurish për Spaçin, vendodhjen e tij, karakteristikat fizike si dhe me informacion të marrë drejtpërdrejt nga ish të burgosur politikë në Spaç. Njohuritë e grumbulluara në këtë mënyrë do të përdoren në hapat e mëtejshëm të projektit. Së fundmi, punëtorja I kishte për qëllim gjithashtu të lokalizonte Spaçin brenda rrjetit më të gjërë të pikave turistike që ofron rrethi i Mirditës.

WORKSHOP AGENDA

AXHENDA E REALIZUAR

DAY 1 | THURSDAY, JUNE 12

- 07:30 Departure for Reps for participants from Tirana (minibus transport)
- 10:00 Arrival in Reps for participants from Reps, Shkodra and Tirana
- 10:30 Departure for group visit to Spaç prison
- 12:30 Accommodation/lunch at Hotel Marub, Rubik
- 14:00 Welcome, goals and methodology of Workshop I
- 14:30 **Joint discussion:** Impressions from the visit to Spaç prison
- 15:30 Coffee break
- 16:00 **Group work & presentations:** SWOT analysis for Spaç prison
- 19:00 Dinner

DAY 2 | FRIDAY, JUNE 13

- 09:00 **Joint discussion:** Spaç prison in popular culture today
- 09:30 **Joint discussion:** Life inside Spaç, testimonies from former political prisoners
- 10:30 Coffee break

DITA 1 | E ENJTE, 12 QERSHOR

- 07:30 Nisja për në Reps për pjesëmarrësit nga Tirana (transporti me minibus)
- 10:00 Mbërritja në Reps e pjesëmarrësve nga Repsi, Shkodra dhe Tirana
- 10:30 Nisja për vizitë në grup në burgun e Spaçit
- 12:30 Akomodimi në Hotel Marub, Rubik dhe dreka
- 14:00 Mirësardhja, qëllimi & metodologjia e punëtorisë I
- 14:30 **Diskutim i përbashkët:** Mbresat nga vizita në burgun e Spaçit
- 15:30 Pushim për kafe
- 16:00 **Punë & prezantim në grup:** Analiza SWOT për burgun e Spaçit
- 19:00 Darka

DITA 2 | E PREMTE, 13 QERSHOR

- 09:00 **Diskutim i përbashkët:** Spaçi në kulturën popullore sot
- 09:30 **Diskutim i përbashkët:** Jeta brënda në Spaç, dëshmitë nga ish të burgosurit politikë
- 10:30 Pushim për kafe

- 11:00 **Group work & presentations:** Group viewing of excerpts from testimonies of former political prisoners in Spaç filmed by AHRP
- 12:30 Lunch
- 14:00 **Group work & presentations:** Compiling mind maps of Spaç, based on the collected testimonies
- 15:30 Coffee break
- 16:00 **Group work & presentations:** Finishing the mind maps and presenting them to everyone
- 17:00 **Joint discussion:** Next steps for the dialogues project
- 17:30 Short visit in Rubik
- 19:00 Dinner

DAY 3 | SATURDAY, JUNE 14

- 09:00 Departure for an organized visit to local cultural heritage sites in Mirdita
- 13:00 Lunch
- 14:00 Evaluation of Workshop I by the participants
- 15:00 End of the workshop and departure of the participants

- 11:00 **Punë & prezantim në grup:** Vizionimi në grup i ekstrakteve të dëshmive të ish të burgosurve politikë në Spaç, të filmuara nga AHRP
- 12:30 Dreka
- 14:00 **Punë & prezantim në grup:** Përpilimi i hartës mendore të Spaçit bazuar tek dëshmitë e mbledhura
- 15:30 Pushim për kafe
- 16:00 **Punë & prezantim në grup:** Përfundimi i hartave dhe prezantimi i tyre nga grupet
- 17:00 **Diskutim i përbashkët:** Hapat e mëtejshëm të projektit
- 17:30 Mini-vizitë në Rubik
- 19:00 Darka

DITA 3 | E SHTUNË, 14 QERSHOR

- 09:00 Nisja për vizitën e organizuar në lokalitetet e trashëgimisë kulturore të Mirditës
- 13:00 Dreka
- 14:00 Vlerësimi i punëtorisë I nga pjesëmarrësit
- 15:00 Përfundimi i punëtorisë dhe nisja e pjesëmarrësve

LIST OF PARTICIPANTS

LISTA E PJESEMARRRESVE

NR.	NAME EMËR	INSTITUTION / ORGANIZATION	INSTITUCIONI / ORGANIZATA
1.	Aleksandër Lala	Orosh Commune, Mayor	Komuna Orosh, Kryetar
2.	Drita Nikolli	Orosh Commune, Archivist/Secretary	Komuna Orosh, Arkiviste/Sekretare
3.	Elton Nikolli	Orosh Commune, Economic Enterprises Administrator	Komuna Orosh, Administrator i Ndërmarrjeve Ekonomike
4.	Gjeto Gjoni	Spaç prison caretaker, local resident	Kujdestar i burgut të Spaçit, Banor vendas
5.	Aurora Kamberi	Ministry of Culture, Directorate of Material Heritage and Museums, Sector Head	Ministria e Kulturës, Drejtoria e Trashëgimisë Materiale dhe Muzeve, Përgjegjëse sektori
6.	Inis Morina	Ministry of Social Welfare and Youth, Directorate of Policies for Former Politically Persecuted People, Specialist	Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Drejtorinë e Politikave për ish të Përndjekurit Politikë, Specialiste
7.	Andronira Burda	Ministry of Urban Development and Tourism, Directorate of Territorial Development, Specialist	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Drejtoria e Zhvillimit të Territorit, Specialiste
8.	Zenel Drangu	Former political prisoner in Spaç, Head of the Association of Former Politically Persecuted People, Shkodër branch	Ish i burgosur politik në Spaç; Kryetar i Shoqatës së ish të Përndjekurve Politikë, dega Shkodër
9.	Fabian Kati	Former political prisoner in Spaç, UET, researcher/director	Ish i burgosur politik në Spaç, UET, Kërkues/regjizor
10.	Luigi Mila	“Spaç Prison Museum” Association, Head	Shoqata “Muzeumi Burgu i Spaçit”, Kryetar
11.	Vladimir Banushi	“Spaç Prison Museum” Association, Project Assistant	Shoqata “Muzeumi Burgu i Spaçit” Asistent Projekti
12.	Dafne Bajraktari	University of Tirana, Faculty of History & Philology, Journalism Dept., Student	UT, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Dpt i Gazetarisë, Studente

13.	Nedina Dajko	University of Tirana, Faculty of History & Philology, Journalism Dept., Student	UT, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Dpt i Gazetarisë, Studente
14.	Jonathan Eaton	Cultural Heritage without Borders (CHwB), Program Coordinator	Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Koordinator programi
15.	Nedi Petri	Cultural Heritage without Borders (CHwB), Project Assistant	Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Asistent projekti
16.	Mirian Bllaci	Cultural Heritage without Borders (CHwB), Project Manager	Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Menaxher projekti

Also present during part of the working sessions were:

Të pranishëm gjatë sesioneve të punës ishin dhe:

17.	Silva Breshani	Ministry of Culture, National Center for Inventory of Cultural Wealth, Director	Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Drejtoreshë
18.	Etleva Goxhaj	Ministry of Culture, National Center for Inventory of Cultural Wealth, Sector Head	Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Përgjegjëse sektori
19.	Ilda Papajani	One Prod, Photographic director	One Prod, Drejtoreshë fotografie

Fig. 3: Visit to Spaç prison | Vizita në ish burgun e Spaçit



THE WORKING PROCESS

PROCESIT PUNES

Site visit to Spaç

The visit to the former prison of Spaç was the opening activity of the workshop. First, during the visit, we wanted all of the participants to observe up close the deteriorated condition of the site today. On the other hand, through the impression that Spaç has, especially on those who are visiting for the first time, we wanted the participants to come face to face with this place that even today causes an intense experience for visitors. This personal confrontation with Spaç would provide both an awareness raising for the urgent physical interventions needed at Spaç prison, as well as a kind of “ice-breaker” between participants from different professional and personal backgrounds.



Fig. 5 & 6: Encounter between generations: one of the key points of the Dialogues for Spaç project | Ballafaqimi mes brezave: një nga pikat kyçe të projektit të Dialogjeve për Spaçin

Vizita në Spaç

Vizita në ish burgun e Spaçit ishte aktiviteti çelës i punëtorisë. Së pari kërkohet që përmes vizitës të gjithë pjesëmarrësit të njiheshin nga afër me gjendjen e degraduar të tij sot. Nga ana tjetër nëpërmjet përshtypjeve që do krijonin sidomos ata pjesëmarrës që në Spaç ishin për herë të parë, kërkohet që përbalja me këtë vend që ende sot shkakton përjetime të forta tek vizitorët, një efekt ndërgjegjësimi për karakterin urgjent të trajtimit të burgut të Spaçit, ashtu si një lloj “thyerje e akullit” mes pjesëmarrësve të horizonteve të ndryshme profesionale e njerëzore.



Fig. 4: A part of the group near the former entrance of the prison | Një pjesë e grupit pranë hyrjes së dikurshme të ish burgut



Impressions

The first exercise of the workshop was a discussion of impressions from the visit to Spaç. Each participant was asked to reflect on the spaces, events or sensations evoked by Spaç, whether they were from that day's site visit or earlier. Then, with the help of colored sticky notes, each person marked out their important places, memories and impressions on either a perimeter map or photographic panorama of the former prison – each note containing a short description. This first exercise had an interesting outcome. Immediately after everyone placed their colored sticky notes, it was possible to identify, either visually or by the content of the notes, elements that could become poles of interest for further research – and perhaps even shared with the public as a part of turning Spaç prison into a museum.



Fig. 7: Sticky notes with impressions, placed by participants on a panorama photograph of Spaç | Mbresat e përjetimet e vendosur nga pjesëmarrësit në foton panoramike të Spaçit

These poles of interest are, respectively:

Spaces, integral places for the former prison, past and present:

- “Meeting rooms for the prisoners and their families”, “Visitor reception place”, “Meeting place / control point”, “Drawing of a television on the wall of one of the cells”, “Prisoners’ writings”, “Notes on the walls”
- “The numbering platform, where the prisoners found a bit of freedom”
- “The most touching part, the prisoners’ sleeping area, with small rooms”, “Sleeping rooms”, “Sleeping rooms.

Mbresat

Ushtrimi i parë i punëtorisë ishte diskutimi i mbresave dhe përshtypjeve nga vizita në Spaç. Secilit pjesëmarrës iu kërkua të reflektonte për hapësirat, ngjarjet apo përjetimet nga Spaçi, qofshin këto të sotshmet apo dhe më të hershme. Më pas me ndihmën e letrave ngjitëse me ngjyrë, secili shënoi në hartën e perimetrit dhe në fotografinë panoramike të ish burgut, vendet, kujtimet e mbresat duke ofruar për secilën nga këto nga një përshkrim të shkurtër. Interesi i këtij ushtrimi të parë ishte që menjëherë pas vendosjes së letrave me ngjyrë u bë i mundur identifikimi, qoftë vizualisht, qoftë për nga ana përmbajtësore, i elementëve që mund të jenë nesër pole me interes për tu hulumtuar më tej, e pse jo trajtuar e servirur publikut në kuadrin e muzealizimit të burgut të Spaçit.

Këto pole janë përkatësisht:

Hapësirat, situatat përbërëse të ish burgut dikur dhe sot:

- “Dhoma e takimit të të burgosurve me familjarët e tyre”, “Vendi i pritjes së vizitorëve”, “Vend takimi/pika e kontrollit” “Vizatimi i një televizioni në murin e një prej qelive”, “Shkrimet e të burgosurve”, “Shënimet në mure”
- “Sheshi i numurimit ku të burgosurit gjenin pak liri”
- “Pjesa më e prekshme, fjetorja e të burgosurve, me dhomat e vogla”, “Dhomat e fjetjes”, “Dhomat e fjetjes.

- Memories”, “Conditions in the sleeping rooms”
- “Signs of the former surrounding fence”
- “Difficulties that prisoners and their families faced trying to meet each other”
- “The curves [of the road], a bitter memory”
- “The tree of ‘resistance’ (which sprouted where the red flag without the [Communist] star was once raised)”
- “The building designed by Maks Velo, who later ended up there himself”

Mine galleries where political prisoners once worked:

- “The mines as a cruel oppression against these boys”
- “Entrances to the mines”, “The mines”



Fig. 8: Sharing impressions from the site visit | Momente nga sesiioni i mbresave nga vizita

- Kujtimet”, “Kushtet në dhomat e gjumit”
- “Shenjat e rrethimit të dikurshëm”
- “Vështirësitë e takimeve mes të burgosurve dhe familjarëve të tyre”
- “Kthesa, kujtesë e hidhur”
- “Pema e ‘rezistencës’ (e mbirë aty ku dikur u ngrit flamuri pa yllin e kuq)”
- “Objekti i projektuar nga Maks Velo, i cili më vonë përfundoi vetë aty...”

Minierat dhe galeritë ku dikur punonin të burgosurit politikë:

- “Minierat si shtypje mizore ndaj këtyre djemve”
- “Hyrjet e minierave”, “Miniera”



Fig. 9: Sharing impressions from the site visit | Momente nga sesiioni i mbresave nga vizita

The link between the former prison and its immediate natural context and the effects of this on people:

- “Depth, difficulty of the location”, “Difficulty of the terrain”, “Excessive isolation”, “Desolation / wasteland”, “Terrain where the prison is located, totally isolated”
- “I don’t know precisely where the prison ends and nature begins”
- “The effect of such a natural environment on people”
- “The yellow river that spews from the mine”

The diversity of interpretations and emotional weight that are still caused by the former prison:

- “Hope”, “Suffering and healing”, “Pleasure”
- “Silence – quiet, pain that brings you to humility”, “Humiliation”

Lidhja e ish burgut me kontekstin e tij të afër natyror dhe efektet te njeriu:

- “Thellësia, vështirësia e vendodhjes”, “Vështirësia e terrenit”, “Izolimi tejmasë”, “Shkretia”, “Relievi ku është vendosur burgu tërësisht i izoluar”
- “Nuk e di fiks ku mbaron burgu dhe fillon natyra”
- “Efekti i asaj natyre mbi njeriun”
- “Lumi me ngjyrë të verdhë që vjell miniera”

Larmia e interpretimeve dhe ngarkesa emocionale që shkakton ende ish burgu:

- a) “Shpresë”, “Vuajtje dhe shërim”, “Kënaqësi”
- “Heshtje – qetësi, dhimbje deri në përlësi”, “Poshtërim”
- “Unë si biri i atij vendi të bukur dhe historik të fshatit

- “As a son of this beautiful and historic place – the village of Spaç, when I hear from former prisoners, I cannot imagine the suffering, terror, torture, death meted out by that ruthless regime, and this, a beautiful place, was made into a black hole in my village. Lord, have mercy.”
- “Engagement”, “Youth participation and sensitization”, “Stability”
- “Nostalgia for the years that I passed there and pleasure that I met great people there”
- “1+1=3 : the physical aspect, the aspect of memory and the power of meditation”

- Spaç nuk mund ta imagjinoj kur dëgjoj nga ish të dënuarit vuajtje-tmerr turtura-vdekje nga ai regjim i pamëshirshëm, dhe kjo nga një vend i bukur u ba një vrimë e zezë në fshatin tim. Zoti pastë mëshirë”
- “Angazhim”, “ Pjesëmarrja dhe sensibilizimi i rinisë”, “Stabilitet”
- “Nostalgjia për vitet që kalova atje dhe kënaqësi që kam takuar aty njerëz të mëdhenj”
- “1+1=3: aspekti fizik, aspekti i kujtimeve dhe fuqia e meditimit”




Fig. 10: Some of the results as they were placed by participants themselves | Disa nga rezultatet ashtu siç u vendosën nga vetë pjesëmarrësit



Fig. 11: Moments from the SWOT analysis session | Momente nga sesioni i SWOT analizës

SWOT Analysis

The current condition of the former prison of Spaç is sometimes closely linked with the local context and at other times with the dynamics of the larger national context. The site is under the influence of different economic, social and political processes that are taking place within society today. Therefore, in dealing with the problems that face Spaç today, it is important to make a clear overview of these developments.

In what ways should we be considering saving Spaç prison from destruction? What are the internal and external factors that influence the achievement of the objectives of protecting Spaç and turning it into a museum?

In order to get an idea of the current strategic situation of the site, participants of the first workshop conducted a SWOT analysis. This method provides a quick picture of the general context surrounding the site by looking at four areas:

- Strengths
- Weaknesses
- Opportunities
- Threats

During the workshop, participants broke into three small groups to discuss these aspects, coming together at the end of the session to compile a joint SWOT analysis, showing

Analiza SWOT

Gjendja e ish burgut të Spaçit është e lidhur ngushtë qoftë me kontekstin lokal, qoftë me dinamikat e një konteksti më të gjere kombëtar. Ajo është nën ndikimin e proceseve të ndryshme ekonomike, sociale dhe politike të cilat ndodhin në shoqëri. Ndaj në përballjen me problemet që has sot çështja e Spaçit, është me rëndësi që të bëhet një pasqyrë e qarte e të gjithë zhvillimeve.

Në çfarë kushtesh duhe menduar shpëtimi nga rrënim i ish burgut të Spaçit? Cilët janë faktorët e brëndshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në arritjen e objektivit të vënies në mbrojtje dhe muzealizimit të Spaçit?

Ky skanim i përgjithshëm i kontekstit rrethues mund të realizohet me anë të analizës SWOT, emri i së cilës rrjedh nga shkronjat e para të fjalëve në gjuhën angleze:

- Strengths - Përparësitë
- Weaknesses - Dobësitë
- Opportunities - Mundësitë
- Threats – Kërcënimet

Gjatë punëtorisë I, pjesëmarrësit u ndanë në tri grupe prej të cilëve u përpilua në fund një SWOT i përbashkët. Gjatë përgatitjes si dhe gjatë prezantimit të SWOT-it, secili grup pati diskutime të pasionuara dhe të frytshme. Ky ushtrim bëri të mundur përpilimin e një pasqyre të qartë për gjendjen

the existing situation of Spaç itself, as well as the larger social context surrounding it. The exercise itself encouraged passionate and productive discussion and enabled the exchange of different viewpoints and experiences among the participants.

The results of this SWOT analysis are as follows:

Strengths:

- History of Spaç and the heritage of the region where it is located (Mirdita)
- The still untouched nature that surrounds Spaç
- Existing infrastructure, which still gives the sense of a place of Communist persecution and which can evoke a strong impression from visitors (the road to the former prison, the buildings and interior spaces, the mines, etc.)
- The subject of Spaç is known and perceived as an important national issue
- Existence of local will to protect and revitalize Spaç as a site of memory
- Existence of a legal framework for the protection of the former prison of Spaç
- Strong intangible connection between the local community and Spaç
- Existence of supportive NGOs actively engaged in saving the former prison of Spaç



Fig. 12: Moments from the SWOT analysis session | Momente nga sesioni i SWOT analizës

Weaknesses:

- Irreversible degradation of the existing infrastructure inside the former prison
- Weak infrastructure for basic services (water, sewer/

ekzistuese të vetë Spaçit dhe të kontekstit shoqëror përreth tij, ashtu siç mundësoi shkëmbimin e këndvështrimeve dhe përvojave të ndryshme mes pjesëmarrësve.

Rezultatet e SWOT-it mund ti gjeni në vijim:

Përparësitë – Strengths:

- Historia e Spaçit dhe trashëgimia e krahinës ku ai shtrihet (Mirdita)
- Natyra ende e paprekur që rrethon Spaçin
- Infrastruktura ekzistuese që ende jep idenë e një vendi të persekutimit Komunist e që ngjall tek vizitori përjetime të forta (rrugëtimi për në ish burg, godinat dhe hapësirat brënda, minierat, etj)
- Çështja e Spaçit njihet dhe perceptohet si çështje me rëndësi kombëtare
- Ekzistenca e vullnetit lokal për të mbrojtur edhe rijetëzuar Spaçin si vend kujtese
- Ekzistenca e një kuadri ligjor për mbrojtjen e ish burgut të Spaçit
- Lidhja shpirtërore e fortë mes komunitetit lokal dhe Spaçit
- Ekzistenca e OJQ-ve përkrahëse dhe aktivisht të angazhuara për shpëtimin e ish burgut të Spaçit



Fig. 13: Moments from the SWOT analysis session | Momente nga sesioni i SWOT analizës

Dobësitë – Weaknesses:

- Degradimi i pandalshëm i infrastrukturës ekzistuese brenda në ish burg
- Infrastruktura e dobët e shërbimeve bazike (ujë,

- drainage, roads, etc.)
- Gradual disappearance of witnesses to the facts of life in Spaç (degradation of objects and passing away of those people who have once been there)
- Negligence by governmental structures, including those that represent the former-persecuted themselves, for implementing concrete ideas at the site
- Relative isolation and distance from the primary urban centers
- Limited economic possibilities for maintenance
- Limited economic opportunities for investment in and around the former prison
- Lack of information and awareness among youth

- kanalizime, rrugë, etj.)
- Zhdukja graduale e dëshmvive faktike të jetës në Spaç (degradimi i objekteve dhe largimi nga jeta i atyre që kanë qenë dikur aty)
- Neglizhenca nga strukturat qeverisëse, përfshirë ato që përfaqësojnë vetë ish të përndjekurit, për zbatim konkret të ideve në terren
- Izolimi relativ dhe largësia nga qendrat kryesore urbane
- Mundësitë e kufizuara ekonomike për mirëmbajtje
- Mundësitë e kufizuara ekonomike për investime në dhe përreth ish burgut
- Mungesa e informacionit dhe e ndërgjegjësimit tek të rinjtë



Fig. 14: Moments from the SWOT analysis session | Momente nga sesioni i SWOT analizës

Opportunities:

- 'Musealization' of the former prison of Spaç (turning the site into a museum)
- Tourism development in the zone
- Existence of interested donors
- Intellectual potential from locals, people from the region (Mirdita) and former Spaç prisoners who today are public figures
- Readiness and engagement of some of the former prisoners to make the Spaç issue a priority again
- Coordination and cooperation of interest groups
- Promoting, advertizing and publicizing the issue of Spaç
- Involvement in the system of maintenance and

Mundësitë - Opportunities

- Muzealizimi i ish burgut të Spaçit
- Zhvillimi i turizmit në zonë
- Ekzistenca e donatorëve të interesuar
- Potenciali intelektual lokal, rajonal (Mirdita) dhe ish të burgosur në Spaç që sot janë dikushi
- Gadishmëria dhe angazhimi i disa prej ish të burgosurve për të kthyer në prioritet çështjen e Spaçit
- Koordinimi dhe bashkëveprimi i grupeve të interesit
- Promovimi, reklamimi, publiciteti i çështjes së Spaçit
- Përfshirja në sistemin e mirëmbajtjes dhe investimeve të aktorëve ekonomikë të interesuar në shfrytëzimin e burimeve të zonës (partneritet)

investment of economic actors that are interested in exploiting area mines (partnership)

Threats:

- Younger generations are less and less interested in the problems that Spaç represents
- Interests of economic actors that seek to reuse the mines at the former prison for commercial purposes
- Further physical degradation due to natural factors
- Further physical degradation due to human factors
- Continued politicization of the issue

Kërcënimet - Threats

- Brezat e rinj janë gjithnjë e më pak të interesuar nga problemet që përfaqëson Spaçi
- Interesat e aktorëve ekonomikë që kërkojnë rishfrytëzimin për qëllime tregtare të minierave që kanë qenë dikur të ish burgut të Spaçit
- Degradimi i mëtejshëm fizik për shkak të faktorëve natyrorë
- Degradimi i mëtejshëm fizik për shkak të faktorëve njerëzorë
- Vazhdimi i politizimit të çështjes



Spaç in popular culture today

The opening presentation on the second day of the workshop sought to review the treatment of the issue of Spaç from the perspective of public opinion. The initial conclusion was that Spaç has been an important subject of journalism at more or less regular intervals, as well as in response to developments within the world of politics.

Literature was also mentioned during the discussion, as the genre that has tried the most to 'get inside' Spaç, both the site and the human stories that have characterized it. In addition, there have been initiatives in the field of visual arts (photography, cinematography, documentaries), as well as installations or exhibitions with Spaç as a theme.

However, the discussion closed with a common conclusion about the great need to include Spaç and the wider history of political persecution in school texts. Participants also expressed the need to organize surveys and studies of public opinion that focus on perceptions of the former prison—in particular, a serious study on the reasons for the separation that today's youth have from the topic of persecution during the Communist period.

Spaçi në kulturën popullore sot

